



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MATERIALEVE ZGJEDHORE (FLETË VOTIMI, VULA, KUTI VOTIMI, KODE SIGURIE) TË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE KZAZ NR. 6, QARKU SHKODËR DHE ZËVENDËSIMIN E TYRE.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve zgjedhore (fletë votimi, vula, kuti votimi, kode sigurie) të qendrave të votimit dhe KZAZ-së nr. 6, qarku Shkodër dhe zëvendësimin e tyre me materialet zgjedhore të nevojshme.

BAZA LIGJORE: Neni 21, pika 3, Neni 23, pika 1, germa "a", neni 99, neni 103, pika 1, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

V Ë R E N

KZAZ nr. 6 Qarku Shkodër, ka nisur një informacion sipas të cilit njofton KQZ-në se referuar situatës së krijuar në datë 27.06.2019 në KZAZ-në nr. 06, në Bushat rreth orës 20:00, janë sulmuar duke dhunuar dhe djegur me bomba molotov ambientet e KZAZ-së - 06, Bushat, në të cilën ishte sistemuar e gjithë baza materiale dhe logjistike për zgjedhjet e datës 30.06.2019. KZAZ - 06, gjithashtu bën me dije se gjithçka që ndodhej në ambientet e KZAZ-së është dëmtuar krejtësisht si: materialet zgjedhore, kutitë e votimit, fletët e votimit, kutitë me vulat përkatëse, sistemi i kamerave, pjesa e telefonisë, fotokopje, fax, kompjuter dhe gjithçka tjetër ndodhej në ambientin e palestrës të përdorur nga KZAZ-ja. Nisur nga këto rrethana KZAZ-06 i kërkon KQZ-së zëvendësimin e të gjitha materialeve zgjedhore për të bërë të mundur realizimin e procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019.



Nr. 925 i vendimit

Data 28.06.2019 e vendimit

Ora 18:00 e Vendimit

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve zgjedhore (fletë votimi, vula, kuti votimi, kode sigurie) të qendrave të votimit dhe KZAZ nr. 6, qarku Shkodër dhe zëvendësimin e tyre me materialet zgjedhore të nevojshme

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organi me lartë i ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve vlerësoi rastin e paraqitur dhe konstaton se:

Materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 99 të Kodit Zgjedhor, të cilat KQZ i ka dërguar sipas afateve ligjore pranë KZAZ-së nr. 06 janë dëmtuar, duke bërë të pamundur përdorimin e tyre dhe njëkohësisht nxjerrjen e tyre sipas specifikimeve përkatëse jashtë përdorimit.

Duke qenë se e drejta e votës është një e drejtë e garantuar në Kushtetutën e Shqipërisë, neni 45, pika 1 dhe në Kodin Zgjedhor, neni 3, pika 3, zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore nuk mund t'ju mohohet e drejta e votës. Në këto kushte KQZ do të marrë masat e nevojshme për pajisjen me materialet e nevojshme zgjedhore.

Referuar kohës në dispozicion deri në ditën e zgjedhjeve, rezulton se fletët e votimit për kandidatët për kryetar dhe kandidatët për këshillin e bashkisë Vau i Dejës, do të prodhohen sipas modelit dhe sasisë së miratuar nga KQZ me vendimet përkatëse (vendimi i KQZ-së nr. 690, datë 28.05.2019, vendimi nr. 807 datë 06.06.2019 dhe vendimi i KQZ-së nr. 729, datë 30.05.2019).

Gjithashtu KQZ do të prodhojë vulën e kryetarit të qendrës së votimit për 53 qendrat e votimit të KZAZ-së nr. 06, sipas modelit të miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 04, datë 15.01.2019.

Për sa më sipër KQZ duhet të nxjerrë jashtë përdorimit materialet zgjedhore si fletë votimi, vulat e KQV-së dhe të kryetarit të KQV-së, kutitë e votimit, kodet e sigurisë, dërguara nga KQZ pranë KZAZ-së nr. 06.

Prodhimin dhe pajisjen e KZAZ-së nr. 06 me 39.527 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzetë e shtatë) fletë votimi për kandidatët për kryetar dhe 39.527 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqindë e njëzetë e shtatë) fletë votimi për kandidatët për këshill të Bashkisë Vau Dejës.

Pajisjen e KZAZ-së nr. 06 me kutitë e nevojshme të votimit për qendrat e votimit dhe kodet e sigurisë përkatëse si dhe të gjitha materialet e nevojshme zgjedhore, për zhvillimin e rregullt të zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 21, pika 3, neni 23, pika 1, germa "a", neni 99, neni 103, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të nxjerr jashtë përdorimit fletët e votimit për kandidatët për kryetar dhe kandidatët për këshillin e bashkisë Vau i Dejës, me numrat serial, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të prodhojë dhe pajisë KZAZ-së nr. 06 me 39.527 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzetë e shtatë) fletë votimi për kandidatët për kryetar dhe 39.527 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqindë e njëzetë e shtatë) fletë votimi për kandidatët për këshill të Bashkisë Vau Dejës.



Nr. 925 i vendimit

Data 28.06.2019 e vendimit

Ora 18:00 e Vendimit

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materieleve zgjedhore (fletë votimi, vula, kuti votimi, kode sigurie) të qendrave të votimit dhe KZAZ nr. 6, qarku Shkodër dhe zëvendësimin e tyre me materiet zgjedhore të nevojshme

3. Të nxjerrë jashtë përdorimit vulat e KQV-ve nr:
0145,0146,0147,0148,0149,0150,0151,0152,0153,0155,0156,0158,0159,0160,0161,0162,
0163,0164,0209,0210,0211,0212,0213,0214,0165,0166,0167,0168,0169,0170,0171,0126.
130,0131,01421,0135,0142,0172,0173,0174,0175,0176,0177,0178,0180,0181,0182,0183,
0184,0185,0188,0189,0190, dhe ti zëvendësojë ato me vulat rezervë të prodhuara sipas
modelit të miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 04, datë 15.01.2019.
4. Të nxirren jashtë përdorimit vulat e kryetarëve të 53 KQV-ve të KZAZ-së nr. 06 me
nr. serial 00335-00387.
5. Të prodhojë dhe të pajis KZAZ nr. 06, me 53 copë vula për Kryetarët e KQV-ve, duke filluar
me numurin serial 05426, sipas modelit të miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 04, datë
15.01.2019.
6. Të dërgojë në KZAZ-në 06, me 106 kuti votimi dhe kuti të materialeve zgjedhore, së bashku
me kodet e sigurisë përkatëse.
7. Të dërgojë në KZAZ-në 06, qarku Shkodër të gjitha materialet e tjera zgjedhore të
parashikuara nga neni 99 i Kodit Zgjedhor, për të realizuar procesin e rregullt zgjedhor.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtar



Nr. 925 i vendimit

Data 28.06.2019 e vendimit

Ora 18:00 e Vendimit

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve zgjedhore (fletë votimi, vula, kuti votimi, kode sigurie) të qendrave të votimit dhe KZAZ nr. 6, qarku Shkodër dhe zëvendësimin e tyre me materiet zgjedhore të nevojshme